



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

VENDIM

Nr. 44, datë 31.01.2024

PËR

TRANSFERIMIN E GJYQTARES {...}, NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NË NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E SË DREJTËS PENALE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 42 dhe 44/2B të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar Vendimit nr. 5 datë 18.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi zgjedhjen për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel, të gjyqtares znj. {...} protokolluar me aktin nr. 6309/25 prot., datë 24.01.2024, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ku është caktuar në mënyrë të përhershme.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR